



Vjeshtë 2010

Përkrahja juaj dhe edukimi

Fletëlahjm ekskluziv për përkrahësit e
Fondit Kosovaro Amerikan për Edukim (KAEF)

Me përkrahjen tuaj, KAEF është në kërkim të liderëve të së nesërme

— Aplikimi, testimi dhe intervistat sigurojnë që përkrahja juaj t'i mbështesë kandidatët më me meritë dhe kualifikim. —

Përkrahja juaj gjenerohe ndaj KAEF-it na ka ndihmuar që t'i ndajmë 46 bursa për nivelin master që nga viti 2005. Ne mundohemi që të sigurojme se secila nga këto bursa t'i jepen individëve nga më të talentuarit, larg-pamësit dhe liderët e së ardhmes së Kosovës. Në mënyrë që të sigurohemi që përkrahja juaj t'i mbështesë më të mirët dhe të talentuarit e Kosovës, çdo vjet KAEF-i merret me një proces selektimi për t'i definuar fituesit e bursës së KAEF-it – dhe të përkrahjes suaj gjenerohe. Ky vit nuk ishte ndryshe. Mëposhtë, mund të njiheni me hapat që KAEF-i i ndërmer në mënyrë që t'i gjejë kandidatët më të mirë:

Aplikimi online. Selektimi për KAEF fillon me aplikacionin online. Aplikacioni përfshinë informatat akademike, esetë, dhe rekomandimet nga kolegët apo profesorët. Këtë vit, 477 kandidatë morrën pjesë në procesin e aplikimit. Ky nivel i lartë i aktivitetit dëshmon se tanimë KAEF-i e ka pozicionuar veten si një lider në mundësitë për edukim. 87 aplikantë e kryen aplikimin me sukses dhe u avansuan në nivelin e dytë të procesit të selektimit. 45% e kandidatëve ishin nga komunat përveç Prishtinës, duke demonstruar se KAEF-i depërton tek kosovarët e talentuar në të gjitha anët e Kosovës.

Seleksionimi primar. Një grup i pavarur i përzgjedhësve janë takuar me datën 8 shtator, për t'i lexuar dhe vlerësuar 87 aplikacionet e KAEF-it. Përzgjedhësit janë zgjedhur në

A e keni parë?

Kosova është përfshirë në Chicago Tribune

A e keni lexuar artikullin fasciues dhe pozitiv mbi Kosovën, të publikuar me 11 korrik në Chicago Tribune?

Link: <http://www.chicagotribune.com/travel/ct-trav-0711-kosovo-20100711,0,6122249.story>

Artikulli i titulluar “Kosova në ngritje,” analizon progresin që Kosova e ka arritur përgjat dekadës së fundit.



Tre pjesëtarët e panelit seleksionues primar diskutojnë aplikacionet e KAEF-it në zyrat e Këshillit Amerikan në Washington, DC. Çdo aplikacion i KAEF-it evaluohet së paku dy here, në mënyrë që secili kandidatë ta ketë mundësinë që ta fitojë bursën.

sajë të eksperiencës së tyre me shkollimin e lartë në SHBA, dhe ata i notuan aplikantët duke u bazuar në disa kritere si potenciali për lidhship, kapaciteti akademik, dhe përkushtimi ndaj Kosovës. Çdo aplikacion është lexuar nga së paku dy përzgjedhës në mënyrë që të sigurohet që secili kandidat është notuar në mënyrë të barabartë.

Intervistat. Komisioni seleksionues primar, nga 87 aplikacione vendosi që t'i avancojë 35 aplikacione në nivelin e radhës, për t'i intervistuar kandidatët me datat 25 dhe 26 shtator në Prishtinë. Këtë vit, ekipi i intervistuesve përbëhej nga stafi i Këshillit Amerikan dhe stafi i specialistëve për përzgjedhje të studentëve nga universitetet amerikane, intervistat u mbajtën në dy grupe të përbëra nga dy intervistues. Universitetet që u përfaqesuan sivjet ishin Michigan State University dhe Colorado State University. Para intervistave, në mbrëmjen e 24 shtatorit, u organizua një gosti në restorantin Tiffany në Prishtinë, ku kandidatët shkëmbyen përvojat e tyre nga procesi i aplikimit dhe filluan të zhvillojnë një lidhje shoqërore në mesin e tyre.

Testimi. Duke u bazuar në intervista, grupi i semi-finalistëve “Tier 2” u krijua. Semi-finalistët e përzgjedhur për listën Tier-2, do t'i marrin testet GMAT dhe GRE në datën 27 tetor. Rezultatet nga këto teste do t'i ndihmojnë komisionit seleksionues në përzgjedhjen e finalistëve.

Seleksionimi final. Pasi që KAEF-i i merr rezultatet e testeve të kandidatëve, e mbledh një tjetër panel seleksionues në Washington, DC. Edhe këaj rradhe paneli përbëhet nga

AMERICAN COUNCILS® FOR INTERNATIONAL EDUCATION
A C T R ▲ A C C E L S

www.support-kaef.org

një grup i pavarur më përvojë në pranim në universitetet e SHBA-ve. Secili aplikacion analizohet së paku nga dy vlerësues. Vetëm pasi që të gjitha aplikacionet të jenë lexuar dhe notuar, ne jemi gati që t'i identifikojmë finalistët.

Shpallja e finalistëve. Finalistët do të identifikohen deri në fund të vitit, dhe vendosja në universitetet e zgjedhura do të fillojë menjëherë. Këtë vit, KAEF-i do t'i ndajë deri në tetë bursa për studim në nivelin master në SHBA, për ta përkrahur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës. Numri i bursave që KAEF do t'i ndajë mvaret shumë nga përkrahjet e donatorëve - si ju!

Profesionistët e Rinj Amerikan (EYP) përkrahin kolegët e tyre në Kosovë

Pjesëmarrësit në programin për Profesionistët e Rinj mbledhin shumën prej \$1,200 në përkrahje të KAEF-it.

Grupi i profesionistëve të rinj arritën t'i mbledhin deri me \$1,200 në mbrëmjen e 1 shtatorit. Ata e organizuan këtë mbrëmje para vizitës së tyre tre javore në Kosovë me programin Profesionistët e Rinj (EYP) të finansuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit si dhe i administruar nga Këshilli Amerikan dhe Rotary Peja. Ky program solli 15 profesionist të rinj kosovarë në zonën e Chicagos për t'u njohur dhe bashkëpunuar me kolegët e tyre në SHBA. Vizita reciproke e amerikanëve në Kosovë u realizua në shtator të këtij viti ku si dhuratë në ndihmë të Kosovës, përfituesit e programit vendosën të mbledhnin fonde në përkrahje të KAEF-it. Kontributet e tyre, me ato te juajat tanimë janë bashkuar në ndihmë të përkrahjes së talentëve të rinj kosovar.

Përkrahja e juaj e vazhdueshme ndaj KAEF-it është thelbësore. Ju lutemi vizitoni www.support-kaef.org të mësoni mbi mënyrën e përkrahjes.

Përkrahja Juaj Ndhmon Shoqërine Civile

Ish-bursistët krijojnë institucione të vlefshme dhe të përjetshme

Kontributi juaj në KAEF jo vetëm që ofron bursa për individë të ndryshëm por së fundi krijojnë edhe ndryshime pozitive në Kosovë nëpërmes ofrimit të cilësisë së lartë në universitetet e zgjedhura – për liderët e ardhshëm të bizneseve dhe institucioneve. Një shembull i këtij ndryshimi është edhe Instituti për Politika të Ballkanit (IPOL), një institut ky i pavarur që “punon për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisjen e mirë përmes politikës pragmatike që shkojnë në të mirë të qytetarëve”. IPOL (<http://policyinstitute.eu/>) u themelua nga Seb Bytyqi, anëtari i grupit të parë të bursistëve të KAEF-it; këtu, të angazhuar me punë dhe programe të tjera janë edhe shtatë ish-bursistë të tjerë të KAEF-it. “Suksesi jonë deri më tani ka qenë në: themelimin e monitorimit të sundimit të ligjit dhe performancës së EULEX-it (Misioni i EU-së në Kosovë), si dhe zhvillimin e rrjetit të shoqërisë civile për të avokuar drejt reformave të reja. Ne kemi ndihmuar në ndryshimin e pikëpamjeve të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile mbi çështjen e llogaridhënjes nga ana e misioneve ndërkombëtare në Kosovë”.

Përkrahja juaj e vazhdueshme për Bursat e KAEF-it ka qenë çështje kyçe në zhvillimin e suksesit të IPOL-it. “Unë kam qenë në gjendje që të shfrytëzoj shkathtësitë dhe përvojat të cilat i kam marrë nga edukimi im në SHBA (përmes Bursës ‘KAEF’) dhe t'i praktikoj ato në menaxhimin e institutit”, tha Bytyqi. “Një bursist i KAEF-it, jo vetëm që shkollohet në një universitet prestigjioz në SHBA, por përfiton edhe nga përvojat e mëdha jetësore dhe dituria e marrë në ambientet e punës në SHBA. KAEF-i u jep studentëve mundësinë dhe vetëbesimin për të filluar me iniciativa të reja, si dhe për të arritur suksese në fushat e tyre përkatese – duke përmirësuar kështu shoqërinë ku jetojnë dhe komunitetin e tyre”. Bursa e KAEF-it, ishte vetëm një fillim i ndërlikueshëm së KAEF-it me IPOL. “Edhe miq të tjerë të KAEF-it janë të angazhuar në IPOL, gjithashtu”, thotë Bytyqi. “Ata janë pjesë e bordit tonë të ekspertëve, dhe ata kontribuojnë dukshëm me analiza, ide, dhe komente në hulumtimet tona”.

Z. Bytyqi dhe IPOL janë shembull i shkëlqyeshëm i ndryshimit pozitiv, i krijuar nëpërmjet edukimit nga kontributet e juaja. Edukimi, dhe eksperiencia e tij në SHBA e kanë ndihmuar atë që ta krijoj një institut të veçantë politikash publike, i cili përkrahet edhe nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) si dhe Agjencioni i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Me ish-bursistë si z. Bytyqi, investimet tuaja në edukimin e individëve të talentuar vlerësohen në tërë Kosovën.

Ju faleminderit, donatorë!



A doni që ta pranoni këtë letër informative në e-mail, apo jo? Kontakttoni Nathan Truitt, në ntruitt@americancouncils.org për ta ndërruar mundësinë e kësaj dërgese.

www.support-kaef.org